



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2018-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR KOMUNËN E RAHOVECIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Kapllan Muhaxheri* Udhëheqës i Ekipit dhe *Fetah Osmani, Fanol Hodolli* dhe *Arian Zenelaj* Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	8
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	12
4 Qeverisja e mirë.....	29
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	33
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	40
Shtojca II: Letër Konfirmim	43

Përmbledhje e përgjithshme

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin Jashtëm të Auditimit, të datës 21/12/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjës

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se llogarit e arkëtueshme për tatimin në pronë 53,515€ dhe obligimet e papaguara 133,918€, nuk ishin shpalosur drejtë në pasqyrat financiare vjetore. Si dhe shpenzimet në vlerë 137,982€ ishin keq klasifikuar, prej të cilave 97,684€ ishin të buxhetuara dhe aprovuara me ligjin e buxhetit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një NJAB më efektive (shih çështjen C5).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Rahovecit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldot fillestare, andaj në PFV kjo llogari ishte e

nënvlerësuar për 53,515€¹. Komuna nuk ka arritur të na ofroj dëshmi për të arsyetuar diferencën e paraqitur; dhe

- Obligimet e vitit 2017 në vlerë 122,516€ nga kategoria e investimeve kapitale si dhe 11,402€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të paguara gjatë vitit 2018, nuk ishin shpalosur si obligime të papaguara te neni 17² në PFV të vitit 2017. Pra kjo llogari ishte nënvlerësuar për 133,918€, andaj edhe saldo fillestare e llogarive të pagueshme për vitin 2018 nuk është e saktë.
- Shpenzimet për mallra e shërbime dhe paga e mëditje në vlerë 113,456€, ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale, nga kjo vlera prej 97,684€, ishte buxhetuar dhe miratuar me ligjin e buxhetit. Këto mjete ishin shpenzuar kryesisht për kontratat: mirëmbajtje sezonale e rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, marrëveshja e bashkëfinancimit. Po ashtu shpenzimet për paga dhe mëditje si dhe shpenzimet për subvencione ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 24,526€³. Sipas komunës shkaku i një keq klasifikimi të tillë ishte mungesa e buxhetit në kategoritë përkatëse edhe pse për shumicën e shpenzimeve ishte bërë aprovimi i buxhetit nga ana e thesarit mirëpo kodet e projekteve ishin keq klasifikuar. Gjithashtu shkaktar tjetër kanë qenë pagesat nga vendimet gjyqësore dhe thesari, pagesat janë bërë duke shfrytëzuar mjetet e lira pa marr parasysh natyrën dhe klasifikimin e drejt të shpenzimit. Pavarësisht arsyetimeve të prezantuara, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto shpenzime nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si kapitale.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

- Komuna e Rahovecit ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme prej 2,115,000€. Në këtë shumë përfshihen të arkëtueshme të vjetërsuara prej shumë vitesh të taksave për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë prej 827,000€, ku mundësia e arkëtimit të tyre

¹Saldo fillestare e të arkëtueshmeve ishte; 1,267,000€, komuna ka faturuar gjatë vitit 446,949€ dhe ka pranuar të hyra në vlerë 419,434€ atëherë saldo përfundimtare duhej të jetë në vlerë 1,294,515€. Ndërsa komuna ka shpalosur vlerën 1,241,000€, duke nënvlerësuar të arkëtueshmeve në vlerën prej 53,515€.

² "Pasqyra e detyrimeve (faturat) e papaguara"/PFV-2017.

³Pagesat në vlerë prej 31,297.65€ sipas vendimeve gjyqësore në 7 raste kane rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve. Prej tyre katër pagesa janë prezantuar si mallra dhe shërbime ndërsa i takonin pagave në shumën prej 15,526.24€; një raste pagesa 14,581.20€ e prezantuar si investim kapitale i takonte pagave; dhe në dy raste pagesat në vlerë prej 1,190.21€ të prezantuar si investim kapital i takonin mallrave dhe shërbimeve. Në 10 raste tjera pagesat 97,683.93€ të prezantuar si investime i takonin mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu në një rast pagesa me vlerë prej 9,000€ e prezantuar si mallra dhe shërbim i takonte subvencioneve.

është minimale. Po ashtu 59% të kësaj llogarie, e përbejnë të arkëtueshmet nga tatiminë pronë;

- Gjatë vitit 2018 komuna është paditur për shuma të konsiderueshme të obligimeve, ku 105,933€ janë kryer pagesa direkt nga thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore; dhe
- Komuna ka një rritje në vazhdimësi të detyrimeve kontingjente ku vlera e tyre ka arritur mbi prej 32 mil.€ me një rritje prej 690,000€ në raport me vitin e kaluar. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Rahovecit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare, nr. 01/2013 Shpenzimi i parasë publike dhe nr. 02/2013 Menaxhimi i pasurisë jo financiare në OB;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e Prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK;

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2019 ishin prezantuar disa gabime, të cilat menaxhmenti i kishte përmirësuar dhe korrigjuara me datë 22/02/2019. Më gjithë përmirësimet e bëra PFV-të ende kishin disa gabime, kryesisht për keq-klasifikimet, si dhe shpalosjet e pasurisë, të arkëtushmeve dhe obligimeve, të cilat i kemi prezantuar tek theksimi i çështjes të opinionit auditimit.

Marrë parasysh çfarë u tha më lartë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Ministrinë e Financave nuk mund të konsiderohet plotësisht e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në klasifikimin e drejt të shpenzimeve dhe për të eliminuar dobësitë në prezantimin e drejt të llogarive të arkëtushmeve dhe obligimeve, të shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit.

Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse komuna ka të dizajnuar një sistem të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat, megjithatë auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, që kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme, detyrimeve dhe klasifikimi i shpenzimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2018 Realizim	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	13,698,232	14,284,134	13,064,949	11,661,181	11,567,016
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,862,731	12,125,110	11,995,391	10,591,533	10,420,032
Të bartura nga viti paraprak ⁵	0	174,221	153,712	205,751	245,380
Të hyrat vetjake ⁶	1,650,027	1,650,027	778,167	769,469	801,797
Donacionet e brendshme	0	6,112	4,853	0	5,400
Donacionet e jashtme	0	95,588	95,493	89,100	94,407
Huamarrja ⁷	185,474	233,076	37,333	5,328	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 585,902€. Kjo rritje është rezultat i rritjes të grantit qeveritar për 262,379€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 174,221€, rritjes së fondeve të huamarrjes 47,602€, fondet nga donatorët e brendshme 6,112€ dhe të jashtëm për 95,588€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar rreth 91.5% të buxhetit final ose 13,064,949€, me një performancë me të dobët se sa realizimi krahasuar më vitin 2017 (96%). Megjithatë, realizimi buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenz. e fond. sipas kateg. ekon:	13,698,232	14,284,134	13,064,949	11,661,181	11,567,016
Pagat dhe Mëditjet	7,296,623	7,259,001	7,219,001	6,991,962	6,966,078
Mallrat dhe Shërbimet	1,563,385	1,585,148	975,106	694,080	657,625
Shërbimet komunale	250,500	250,500	248,823	249,753	250,497
Subvencionet dhe Transferet	191,322	193,514	179,062	188,900	173,992
Investimet Kapitale	4,392,402	4,995,970	4,442,957	3,536,486	3,518,824

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim ;

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

⁶Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁷ Huamarrja nga banka botërore (për drejtorit e Shëndetësisë dhe Arsim).

- Pavarësisht rritjes prej 603,568€ të buxhetit final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale, gjatë vitit vetëm 89% e buxhetit ishte shpenzuar. Ekzekutimi i buxhetit për investimet kapitale i prezantuar në 4,442,957€, në kuadër të realizimit përfshihen edhe pagesat në vlerë prej 1,681,513€ për borxhet e akumuluar nga vitet e mëhershme. Pra shpenzimet reale sipas programit për investime kapitale janë vetëm 2,761,444€ apo vetëm 55% e buxhetit aktual. Nga 86 kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2018 në vlerë prej 7,102,009€, prej tyre 42 kontrata në vlerë 4,157,938€ apo 48% e këtyre kontratave janë nënshkruar në periudhën e fundit vitit, kjo një arsye shtesë/tjetër për mos ekzekutim të buxhetit dhe sfidë që duhet të adresohet nga menaxhmenti.
- Tek kategoria e pagave dhe mëditje, buxheti final ishte rritur për 585,902€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel 99% e buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 21,763€, mirëpo pavarësisht kësaj niveli i realizimit ishte vetëm prej 62%. Planifikimi ambicioz në kategorinë e të hyrave nga grumbullimi i mbeturinave ka reflektuar në realizimin e kufizuar të shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Po ashtu edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 42% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fundit të vitit, kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar mirë me buxhetin në dispozicion;
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk ka ndryshuar krahasuar me buxhetin fillestar dhe komuna ka arrit të shpenzojë 99% të buxhetit për këtë kategori. Po ashtu vlen të theksohet se obligimet në këtë kategori janë zvogëluar për 5,650€ (nga 18,448€ sa ishin në vitin 2017, në 12,799€ në fund të vitit 2018);
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm në vlerën prej 101,700€, që gjatë këtij vitit ishin realizuar 99%. Po ashtu vlera prej 37,333€, ishte shpenzuar nga huamarrja në kategorinë e mallrave 26,081€ si dhe 11,252€ në kategorinë e investimeve edhe atë në Drejtorin e Arsimit dhe Shëndetësisë⁸.

Çështja A⁹1- Dobësi në realizimin e buxhetit

Gjetja Sfidë kryesore me të cilën përballet komuna mbetet ekzekutimi i buxhetit për mallra e shërbime i cili ishte vetëm 62% dhe investime kapitale, pasi 1,681,513€ janë bërë pagesa për borxhet e akumuluar nga vitet e mëhershme dhe ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale vlerësohet të

⁸ 18,884.40(Arsim) si dhe 18,485(shëndetësi).

⁹ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

jetë prej 55%¹⁰. Niveli i ekzekutimit krahasuar me objektivat e synuar nuk ishte arritur pasi menaxhmenti nuk kishte bërë një planifikim real të të hyrave dhe një numër i konsiderueshëm i kontratave ishin lidhur në fund të vitit. Gjithashtu edhe mungesa e një analize të rregullt mbi ecuritë buxhetore ka ndikuar në bartjen e të hyrave në vlerë prej 402,538€ në vitin vijues, si fonde të pashpenzuara.

Rreziku Shfrytëzimi jo efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, më pak projekte për qytetaret dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe i adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Planifikimi buxhetit duhet ti referohet mundësimeve reale për sigurimin e fondeve nga të hyrat dhe realizimit me prioriteti të buxhetit për fshirjen e obligimeve të prapambetura.

3.1.1 Të hyrat

Pranimi i të hyrave për vitin 2018 ishte 994,864€, apo krahasuar me vitin e kaluar komuna ka arkëtimit më të lartë të të hyrave vetjake prej 173,725€ apo shprehur në përqindje 21% më shumë. Si kategori dominuese në strukturën e të hyrave vetjake është arkëtimi i të hyrave nga tatimit në pronë, rreth 42%. Komuna ka arkëtuar tatim në pronë në vlerë prej 419,434€ me një rritje prej 37% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mirëpo komuna ende nuk ka të vendosur kontrolle të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë agregimin e tyre në PFV.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,650,027	1,650,027 ¹¹	994,864	820,959	1,009,926

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna ka pranua të hyra edhe nga dënimet e policisë, gjobat e gjykatave dhe agjencia të pyjeve në vlerë 165,359€.

Realizimi i të hyrave ishte në shkallën 70%, realizim i ulët karshi një planifikimi ambicioz. Kjo për shkak se planifikimi i të hyrave sipas kodit ekonomik "50201" (Licenca aktivitete

¹⁰ Ekzekutimi i buxhetit duke mos përfshirë pagesën e borxheve nga vitet e kaluar.

¹¹ Përfshihet edhe planifikimi i të hyrave nga gjobat në trafik (100,000€), gjobat e gjykatave (120,000€) si dhe nga agjensioni i pyjeve 1,000€

individuale të lirë) ishte prej 400,000€ ndërsa realizimi nga kjo kategori ishte vetëm 842€. Sipas zyrtarëve komunal këto janë të hyra të planifikuara për menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave e cila do të aplikohen për herë të parë gjatë këtij viti, të cilat edhe ishin keqkoduara. Për më tepër edhe te kodit ekonomik "50026" (taksa për legalizimin e objekteve) komuna ka planifikuar 45,000€ të hyra ndërsa realizimi ishte zero. Një planifikim i këtillë ka rezultuar me performancë të dobët në mbledhjen e këtyre të hyrave edhe pse në nivel të pranimit të tërësishme komuna ka treguar progres krahasuar me vitin e kaluar. Të hyrat vetjake prej 931,879€ janë shpenzuar kryesisht për projekte kapitale edhe atë në shkallën prej 90% apo 838,449€.

Çështja A2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Gjetja

Bazuar në Udhëzimin Administrativ 03/2011-"Mbi regjistrimin e pronës", neni 16 i cili rregullon që "Të gjitha objektet e papërfunduara duhet të tatimohen me 40% të vlerës së tregut të objekteve të banimit dhe në llogaritjen e tatimit nuk do të përfshihet zbritja prej 10,000€, shkalla e amortizimit dhe cilësia e ndërtimit". Nga 15 rastet e audituar, në tri raste komuna ka kalkuluar gabimisht tatimin duke përllogaritur normën e kualitetit të ndërtimit me 1.1 (shkëlqyeshëm) për objektet e papërfunduara duke mbivlerësuar rreth 45€ ngarkesën tatimore të faturuar, për këta tatimpagues. Ndërsa në dy raste tjera vlera për m² nuk është përllogaritur në përputhje me rregulloren e tatimit në pronë duke mbivlerësuar ngarkesën tatimore të tatimpaguesit prej 47€. Shkaku ishte vlerësim jo i drejtë i pronave nga ana e anketuesve në teren; si dhe

Sipas Udhëzimit Administrativ 03/2011 dhe rregullores së komunës mbi caktimin e Tatimit në pronë për vitin 2018 tek neni 2 pika 2.3, citohet cilësia e materialit ndërtimor për ndërtimin e objekti ku janë përcaktor 5 kategori. Në dy raste, tatimi në pronë (për afarizëm industrial "bodrum mbi dhe nën tokë") është kalkuluar dhe faturuar me koeficientin të gabuar duke përllogaritur vlerën e tatimit me koeficientet 0.79 në rastin e parë dhe 0.82 në rastin e dytë, koeficient këta që nuk parashihen në rregullore. Të hyrat nga tatimi në pronë për këtë rast janë nënvlerësuar rreth 1,057€. Sipas

zyrtareve përgjegjës ky është një gabim teknik, i cili nuk është vërejtur apo korrigjuar nga komuna.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të arkëtimit, kurse me rastin e mbivlerësimit të barrës tatimore, komuna i ekspozohet humbjes së besimit për trajtim të drejt të tatimpaguesve dhe mund të përballet me padi nga taksapaguesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent.

Çështja B1 - Vonesa në arkëtimin e qerasë dhe taksës për ushtrimin e veprimtarisë**Gjetja**

“Pagesa e qirasë duhet të bëhet më së largu me datën 5 të muajit në vijim nga ana e qiramarrësit, në të kundërtën do të vijë deri tek shkëputja e kontratës dhe arkëtimi i detyrueshëm i borxhit të mbetur” bazuar në nenin-2, të kontratës në mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale”. Në 5 raste shfrytëzuesit e pronës komunale nuk kanë bërë pagesat e qirave sipas kushteve të parapara në kontratë dhe borxhet kanë arritur shumen prej 48,283€. Komuna ka aplikuar vërejtje ndaj këtyre shfrytëzuesve mirëpo nuk ka vazhduar me procedura të mëtejme, që pas 5/15 dite të bëjë ekzekutimin e mbledhjes së borxheve nëpërmes përmbaruesve priva apo edhe shkëputjen e kontratës; dhe

Gjithashtu neni 28, pika 2 i “Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale”, thotë: “Te gjitha subjektet afariste që nuk i përgjigjen pagesës së taksës, tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale të parapara me këtë Rregullore, do të kërkohet ekzekutim i dhunshëm nëpërmes gjykatës kompetente dhe përmbaruesve privat. Mos përgjigjeje e bizneseve për pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë në 10 raste ka shkaktuar akumulimin e borxhe në shumen prej 35,812€, duke mos kryer asnjë pagesë. Komuna ka aplikuar vërejtjet ku janë njoftuar bizneset që brenda afatit 15 ditë të bëjnë përmbushja e obligimit në të kundërtën do të merren masa për ekzekutim të dhunshëm, që përfshinë edhe llogaritjen e kamatës apo mbylljen e lokalit. Komuna nuk ka proceduar as një raste në gjykatë apo përmbarim, për shkak të mbarëvajtjes së punës së bizneseve.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna me qira ka rezultuar me rritje e llogarive të pa mbledhshëm për të hyrat nga taksa në biznes. Mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për arkëtimin e të hyrave, rritë rrezikun e mos realizimit të planit të të hyrave dhe reflekton me më pak projekte kapitale të planifikuar të financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme departamentet përgjegjëse të arkëtoj të gjitha të hyrat e prapambetura. Në të kundërtën të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike apo ushtrimin e veprimtarisë, për mos kryerjen e obligimeve ndaj komunës.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte prej 7,259,001€, ndërsa shpenzimet ishin prej 7,219,001€ apo 99%. Kontrollat kyçe duhet të konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjëseve, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga asambleja komunale. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Numri i stafit të miratuar ishte 1,160 punonjës, ndërsa numri aktual i punonjësve është 1,156 punonjës. Ne kemi audituar procedura të rekrutimit si dhe dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

Çështja A3 – Mangësi në menaxhimin e personelit

Gjetja Për 19 zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri, komuna nuk ishte në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të të cilave kryhet kompensimi i pagave. Sipas menaxherit të personelit nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar dhe kjo dukuri është shfaqur si pasojë e një memorandumit të nënshkruar vite me parë, pasi që zyrtarët janë pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa kompensimi i pagave dhe kompensimet e tjera kryhen nga komuna. Kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për Burimet Njerëzore të Komunës.

Po ashtu Qeveria e Kosovës në bazë të vendimit me Nr. 11/26 i datës 19/05 2010 precizon, të gjithë të kategorizuarit si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil do të përfitojnë mjete financiare në baza mujore në vlerë prej 30€ bruto. Sipas të dhënave të kërkuar nga sektori i MPB kemi identifikuar se këta zyrtar nuk janë të kategorizuar si nëpunës civil, ndërsa kompensohen me shtesën prej 31.2€ për muaj, që në total gjatë vitit 2018 këta punëtorë janë kompensuar në vlerë prej 7,488€. Gjendja e tillë ishte shfaqur sepse zyrtaret janë pjesë e stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si pasojë e memorandumit.

Rreziku

Pagesat për zyrtarët në mungesë të dokumentacionit relevant, rezulton në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës, po ashtu pagesat e shtesave në kundërshtim me vendimin e qeverisë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të komunës.

Rekomandimi A3

Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeverisë dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendim të kthehen buxhetit të komunës.

Çështja C2- Dosjet e pa azhurnuara të personelit**Gjetja**

Vendimit i Qeverisë Nr. 06/29 i datës 15.05.2015, kërkon një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit për dëshminë e viteve të përvojës së punës. Po ashtu Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin para universitar neni 20 paragrafi 2.2 përcakton se drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë detyrat e caktuara për vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit. Nga 21 mostrat e audituar, në nëntë raste në drejtorinë e arsimit dhe dy raste në drejtorinë e shëndetësisë, dëshmitë për vitet e përvojës së punës nuk ishin të pasqyruara në një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për pagesat e përvojës së punës. Po ashtu në drejtorinë e arsimit në dosje mungonin kërkesat e pushimeve si dhe vlerësimet e performancës. Shkaku i kësaj ishte mos koordinimi në mes të shkollave dhe drejtorisë së arsimit si dhe neglizhenca e menaxhmentit dhe stafit përgjegjës.

Rreziku Pagesat e bëra pa dëshmi përkatëse rrisin rrezikun e kompensimit jo real të shtesës për përvojën e punës. Po ashtu mungesa e vlerësimeve të stafit nuk ofron një pasqyrë të saktë të performancës së arritur .

Rekomandimi C2 Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore/shëndetësorë dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë pushimet e stafit dhe vlerësimet e përformcës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalit në vitin 2018 ishte 1,835,648€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,223,929€, apo 66%.

Çështja A4 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

Gjetja Neni 12 pika 4 e Ligjit për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna në vitin 2018 kishte lidhur marrëveshje për shërbime të veçanta me nëntë (9) punonjës, nga gjashtë (6) mostrat e audituar ka rezultuar se komuna ka angazhuar dhe paguar këta punonjës në kohëzgjatjembigjashtë (6) muaj. Komuna fillimisht kishte përdorur bazën e gabuar ligjore duke lidhur kontrata për punë dhe detyra specifike me kohëzgjatje 120 ditë sipas Ligjit të Punës, për angazhimin e stafit civil (si anketues, zyrtar etj) dhe pas përfundimit të këtyre kontratave, ka vazhduar edhe për 6 muaj tjerë me marrëveshje për shërbime të veçanta, bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil. Një dukuri e tillë sipas menaxherit të personalit ka ndodhur për shkak të keqinterpretimeve ligjore.

Rreziku Angazhimet e tilla rezultojnë me parregullsi ligjore dhe mungesa e monitorimit, rrit rrezikon që komuna të pranojë si kundërvlerë kontributin/performancën /shërbimi e duhur nga staf i angazhuar në këtë formë.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për punë specifike bëhet në përputhje të plot me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.

Çështja A5- Mangësi në procesin e pagesave, sipas marrëveshjes për bashkëfinancimi

Gjetja Komuna në prill të vitit 2018 ka lidhur marrëveshje të bashkëfinancimit në vlerë prej 109,315€ (participi i komunës në vlerë 99,815€, ndërsa Caritas Kosova me 9,500€) me mundësi vazhdimi edhe për një vit për projektin “Përkujdes social shëndetësor shtëpiak dhe ambulatore në Rahovec Home Care 2018”. Bazuar në këtë marrëveshje përkatësisht në nenin 5, pika 1.3 përcaktohet se; përzgjedhja e stafit të ri profesional i cili do të angazhohet në këto aktivitete do të bëhet në bashkëpunim në mes të palëve dhe do të jetë në harmoni me procedurat ligjore. Sipas marrëveshjes pika 2.1 me qëllim të zbatimit të marrëveshjes, komuna merr përgjegjësi, të monitoroj zbatimin e projektit (marrëveshjes) dhe pika 2.3 të kontrolloj në mënyrë të vazhdueshme stafin implementues dhe të sigurojë monitorimin e zbatimit të projektit. Në dy (2) raste pagesa për shërbime kontraktuese në vlerë 20,000€ komuna kishte ekzekutuar pagesë për të cilat nuk na janë ofruar dëshmi se janë bashkërenditur aktivitetet sipas marrëveshjes duke filluar nga përzgjedhja e stafit e deri tek raportimi i detajuar i aktiviteteve dhe përmbushjes së qëllimit të projektit. Mungesa e emërimit të një zyrtari përgjegjës për implementimin e marrëveshjes si dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për ekzekutimin e pagesave me kompletimin e dokumentacionit relevant ishte shkak kryesor i mungesës së dëshmive të nevojshme në lëndët përkatëse.

Rreziku Mosrespektimi i obligimeve bazuar në marrëveshje rezulton me kontrole të dobëta dhe rritet rreziku që komuna të pagunë shërbime të cilat nuk janë përfituar apo pranuar nga qytetaret. apo edhe vlerë të dobët për paratë e dhënë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e paratë publike.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 193,514€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 179,062€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike: klube të sportit, OJQ të ndryshme, shoqëri kulturo artistike, për përfitues individual etj.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti aktual për kategorinë e Investimeve Kapitale është: 4,995,970€ ndërsa shpenzimet përgjatë vitit 2018 janë: 4,442,957€ ose shprehur në përqindje 89% e buxhetit. Atokanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, objekteve për banim social etj. Në krahasim me vitin e kaluar, vërehet ekzekutim më një performancë më të mirë të buxhetit në këtë kategori për 906,471€, apo rreth 26%.

Çështja A6 - Dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave për investime

Gjetja Bazuar në Rregullën financiare Nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike, përkatësisht neni 26, pika 2 specifikohet, “se për procedim të pagesës kërkohen paraprakisht: kërkesa për blerje/zotimi, kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit, urdhër blerja, raporti i pranimit, urdhër pagesa, si dhe fatura origjinale”.

Në dy (2) raste komuna kishte ekzekutuar pagesat në mungesë të raportit për pranimin e punëve ku vlera në total e pagesave ishte 15,206€. Shkaku i kësaj dukurie ishte neglizhenca nga ana e stafit dhe përgjegjësia për të implementuar ligjet dhe rregullat në fuqi, ku për pasojë kanë dështuar kontrollet e brendshme.

Rreziku Realizimi i pagesave në mungesë të dokumentacionit përkatës siç kërkohet me ligjet dhe rregullat në fuqi rrit rrezikun që këto pagesa të mos realizohen për qëllimin të cilin janë destinuar apo rrezikun që komuna potencialisht ka paguar punë të cilat mund edhe të mos jen përfunduar.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që personat përgjegjës kontrollojnë dokumentacionin e nevojshëm para ekzekutimit të pagesave si dhe të forcojnë masat e kontrollit që punët apo mallrat pranohen nëpërmes dëshmimeve përkatëse apo raporteve të pranimit.

Çështja A7- Punët e realizuara pas periudhës së skadimit të kontratës dhe vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit

Gjetja Tek kontrata “Ndërtimi i Ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë në Rahovec” përkatësisht pika 10.2 e kushteve të veçanta ndër të tjerash specifikon se kontrata është tri vjeçare, vlera e se cilës është: 517,784€ e nënshkruar më 22/12/2014, dhe do të duhej të përfundonte në dhjetor të vitit 2017, megjithatë kemi vërejtur se në bazë të situacioneve gjatë vitit 2018 janë realizuar dhe paguar 90,000€ pas skadimit të kontratës, po ashtu edhe vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të projektit të kërkuar sipas kontratës kishte skaduar. Me këtë rast komuna nuk kishte ndërmarr asnjë procedurë të nevojshme për të vazhduar kontratën dhe afatin e sigurimit të

ekzekutimit, tashmë të skaduar. Planifikimi i pamjaftueshëm i mjeteve me rastin e lidhjes së kontratës dhe pamundësia e komunës për sigurim të fondeve në vijimësi për implementim të projektit dhe pakujdesia ishin shkaktar për tejkalimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës. Menaxheri i kontratës përmes Organit Mbikëqyrës ka urdhëruar Operatorin që të realizoj punimet në përmbushje të kontratës përkatëse.

Rreziku Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulesë të plot financiar dhe menaxhim i dobët i kontratës ka rezultuar me vonës në implementim të projektit dhe kontrole të dobëta me rastin e pagesës. Realizimi i pagesave pa siguri të ekzekutimit, në rast kontesti rritet rrezikun e përmbushjes së rregull të punëve sipas kontratës. Me këtë rast komuna i ekspozohet edhe rrezikut të vazhdueshëm të menaxhimit të projekteve tjera.

Rekomandimi A7 Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që realizimi i projekteve përmbushët brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe ekzekutimi i të gjitha pagesave të bëhet në pajtim me kontratën dhe të garantohen me sigurim të ekzekutimit duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme.

Çështja A8- Ndryshimi i pozicioneve të para masës së kontraktuar

Gjetja Ndërtimi i rrugës Brestoc - Hoqë e Madhe" dhe "Ndërtimi i rrugëve në Hoqë të Vogël, Brestoc, Krushë të Madhe dhe Fortesë" Sipas nenit 25 pika 1 përcakton "paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e para masës dhe para llogarisë për çdo artikull , në dy (2) raste komuna kishte ekzekutuar pagesën për pozicionet të cilat ishin tejkaluara krahas paramasës së kontraktuar. Pra Organi mbikëqyrës përkatësisht Menaxheri i kontratës nuk kishte respektuar para masën dhe para llogarinë si aneks e kontratës bazë. Planifikimi jo-adekuat i projekteve, përkatësisht mungesa e hartimit të projekteve ekzekutive para inicimit të procedurave të prokurimit ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda para masës së kontraktuar.

Rreziku Tejkalimi i pozicioneve të përcaktuara në marrëveshje kontraktuale përbën shkelje të Kontratës dhe si e tillë rrit rrezikun që operatori të mos kryej punët sipas standardeve dhe cilësisë së përcaktuar sipas kontratës fillestare. Paramasat jo korrekte sjellin shpenzime shtesë dhe vonesa në realizim.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat, duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv si dhe duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve ku gabimet e tilla të mos përsëriten.

Çështja C3 - Nënshkrimi i kontratave pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve

Gjetja Sipas rregullës financiare Nr.: 01/2013 për shpenzimin e parasë publike “asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve” gjithashtu “organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit kemi vërejtur se në një rast kontrata është nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratës së nënshkruara ishte 16,480€, derisa zotimi i mjeteve ishte vetëm 15,000€. Gjithashtu nga testimi i pagesave për qëllime të pajtueshmërisë, në 49 raste komuna kishte pranuar faturën së bashku me dokumentacionin mbështetës para datës së kërkesës për zotim të mjeteve, shuma e këtyre pagesave është: 2,692,026€. Kjo dukuri rezulton nga planifikimi jo i duhuri buxhetit, inicimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave në mungesë të disponueshmërisë së mjaftueshme financiare dhe zotimit të mjeteve.

Rreziku Hyrja në obligime pa fonde të zotuara rritë rrezikun që projektet të mos financohen në tërësi dhe të rezultojë me dështim të kryerjes së tyre. Gjithashtu rritet niveli i rrezikut se mund të krijohen shpenzime të interesave, gjobave për shkaka të vonesave për pagesa.

Rekomandimi C3 Kryetari të siguroj që zyra e prokurimit të ketë kontrolle të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve.

Çështja A9 Lëshimet Aritmetikore në paramasën e kontraktuar

Gjetja Sipas Udhëzuesit për prokurim publik, përkatësisht pika 41.8 Autoriteti Kontraktues (AK) do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se (2%) e vlerës totale të ofertës. Në rast se shuma e korigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim operatorin në fjalë duke përdorur formën standarde apo Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit. Në rast se operatori në fjalë nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta do të refuzohet. Autoriteti Kontraktues gjithashtu duhet të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Në tri (3) raste komuna kishte nënshkruar kontratat për punë ku ofertuesit kishin bërë lëshime aritmetikore në paramasën me të cilat kishin ofertuar. Lëshimet ishin nën normën e lejuar me Ligjin e Prokurimit Publik, mirëpo i njëjti nuk ishte identifikuar nga komisioni vlerësues e as nga zyrtarët e prokurimit, duke reflektuar edhe në para masën e kontraktuar. Shkaku i një

lëshimi të tillë ishte mungesa e kompetencës nga ana e anëtarëve të komisionit vlerësues dhe zyrtarëve të prokurimit.

Rreziku Mungesa e korrigjimeve të nevojshme bazuar në kriteret ligjore, rrit rrezikun që gabimet e njëjta të përcillen deri në përfundim të kontratave dhe si të tilla të kenë implikime financiare për të cilat komuna nuk i kishte identifikuar me kohë.

Rekomandimi A9 Kryetari, përmes Menaxherit të prokurimit duhet të sigurojë se çdo procedurë e prokurimit të analizohet dhe vlerësohet me kujdes nga ana e komisionit vlerësues, në mënyrë të evitohen gabimet e mundshme gjatë procesit të prokurimit gjithashtu të sigurohen që po respektohen kriteret e përcaktuara ligjore.

Çështja A10- Mungesa e projektit ekzekutiv.

Gjetja Sipas Udhëzuesit të prokurimit publik i nxjerre nga KRPP përkatësisht pika 20.13 specifikon si në vijim: Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjese të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Kemi identifikuar se;

Tek kontrata “Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve LOT II” në vlerë prej 87,765€, komuna nuk kishte realizuar hartimin e projektit ekzekutiv ashtu sikur edhe kërkohet. Shkaqet e mos hartimit të projektit ishin dilemat e personave përgjegjës mbi hartimin ose jo të projektit ekzekutiv për kontratën kornizë për punë.

Rreziku Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi A10 Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore dhe zyra e prokurimit para inicimit të procedurave të prokurimit për ekzekutimin e punëve të posedoje projektet e kompletuara.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Çështje për vëmendje mbeten pagesat të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore dhe dispozitave sipas nenit 39.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP):

Çështja A11 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore

Gjetja Nga 13 rastet e audituar kemi vërejtur se Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe dispozitave të nenit 39.2 të LMFPP ka ekzekutuar pagesa në favor të operatorëve dhe zyrtarëve komunal prej 105,933€, nëntë(9) prej tyre kanë rezultuar me shpenzime shtesë prej 4,360€ si shpenzime për procedurë përmbartimore, interesit etj. Kryesisht vonesat në pagesën e obligimeve për shkak të mos planifikimi me kohë, sidomos për pagesën e pagave jubilarë për zyrtaret me rastin e pensionimit.

Rreziku Hyrja në obligime pa sigurimin e mjeteve, vonesat në zbatimin e marrëveshjeve si dhe mos planifikimi dhe kompensimi i pagave jubilarë shkakton vazhdimësinë e dukurisë së ekzekutimit të pagesave nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore, ku shpenzime shtesë administrative mund të ndodhin. Kjo ç'ekuilibron projeksionet buxhetore dhe rrezikon arritjen e objektivave dhe realizimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A11 Kryetari i Komunës duhet të forcoj kontrollin për tu siguruar se disponojnë fonde të nevojshme për përmbushjen e obligimeve financiare me kohë. Më tej të siguroj se komuna trajton të gjitha obligimet ligjore ndaj pretendentëve legjitim dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim të eliminimit të shpenzimeve të panevojshme shtesë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2018 ishte prezantuar në vlerë prej 81,807,000€, Arsye e rritjes së vlerës së pasurisë për 19,502,000 ishte kryesisht për shkak të vlerësimit të pasurisë nga komisioni i vlerësimit ku tokave u është rritur vlera nga 15,093,000€ në 30,495,000€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 470,000€. Ne kemi rishikuar nëse procesi mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja C4 - Mangësi në inventarizimin e pasurisë.

Gjetja Raporti i komisionit për inventarizimin e pasurisë ishte i mangët, përmban pasurinë e komunës, por jo edhe pasuritë jo financiare të stoqeve të derivateve të naftës në QKMF, Neni 19.4 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare thekson se përgjegjësitë e komisionit për inventarizim ndër të tjera janë “Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore”. Në bazë të informatave nga zyrtar përgjegjës dhe verifikimi nga ana e ekipit kemi vërejtur se aty ekziston një sasi prej 3,000 litrave. Ne po ashtu kemi vërejtur se furnizimi i fundit me derivate ishte bërë me datën 25/12/201 në sasi prej 10,000 litrave. Një lëshim i tillë ka ndodhur nga mos informimi i komisionit për sasinë ekzistues të derivateve në rezervar.

Rreziku Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund ti ekspozohen humbjes apo tjetërsimit. Kjo mund të rezultojë në pasqyrat financiare të pasurive të cilat kanë vlerë më të ulët se ajo me të cilën ata janë prezantuar në PFV.

Rekomandimi C4 Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

Çështja A12- Menaxhim jo adekuat i autoparkut

Gjetja Siç kërkohet nga UA Nr.3-2008 - për menaxhimin e automjeteve zyrtare, janë përcaktuar formularët për përdorim të veturave zyrtare. Në tri raste gjate përdorimit të veturave në drejtorin e Administratës, Arsimit dhe QKMF, kemi gjet se nuk është plotësuar formularët për shfrytëzimin e automjeteve, siç kërkohet nga UA. Gjithashtu formulari, urdhër për shfrytëzimin e automjeteve nuk ishte nënshkruar nga zyrtari kompetent, Autorizuesi i automjetit. Situata është pasoje e neglizhencës së zyrtareve kompetent komunal, mos ndarje e detyrave dhe mungesa kontrolleve të mjaftueshëm mbi menaxhimin e autoparkut.

Rreziku Mungesa e kontrollit në menaxhimi e automjeteve zyrtare rrit rrezikun e shpenzimeve të pajustificueshme dhe mundësinë e përdorimit jo zyrtar të automjeteve komunale.

Rekomandimi A12 Kryetari duhet të siguroj se do të hartohet një politik e brendshme e cila definon qartë kërkesat dhe përgjegjësitë për përdorimin e veturave. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se gjatë përdorimit të automjeteve zyrtare azhurnohen fletudhëtimet dhe veturat përdoren vetëm sipas aprovimeve të personave përkatës.

3.3 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 2,115,000€. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me tatimin në pronë, në vlerë 1,241,000€, taksa në firmë 827,000€, nga qiraja në pronë 38,000€ etj.

Çështja A13 - Niveli i lartë i të arkëtueshmeve

Gjetja Edhe pse komuna përballet me vlerën e lart të llogarive të pa arkëtuar, ende nuk ishte hartuar apo aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e të arkëtueshmeve nga vitet paraprake, në veçanti nga tatimi në pronë, taksat në firmë si dhe borxhet nga qiraja. Shkaku është mos vendosja e mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra. Përpos aplikimit të vërejtjeve si masë e përdorur nga komuna, mungonin veprime të vazhdueshme si iniciimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve nëpërmes organeve tjera kompetent.

Rreziku Mungesa e mekanizmave ka rezultuar me vlerë të lartë të të arkëtueshmeve që rrisin rrezikun e vjetërsimit të këtyre llogarive si të pa mbledhshëm me kohë si dhe reflektojnë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve.

Rekomandimi A13 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 2,243,767€ sa ishin në fund të vitit 2017 kanë shënuar rënie në vlerë prej 1,435,458€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme. Komuna përballet edhe me detyrime kontingjente ku në PFV janë prezantuar në vlerë prej 32,695,000€

Çështja A14 - Niveli i lartë i obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Për më tepër, kemi identifikuar 57 raste në vlerë prej 1,716,604€ që e kanë tejkaluar afatin ligjor. Shkaku i kësaj dukurie ishte hyrja në obligime pa fonde të mjaftueshme, dhe mos funksionimi i kontrolleve të brendshëm.

Rreziku Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

Rekomandimi A14 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që mund t'i kontribuojnë një qeverisje të mirë, si dhe mundësitë ekzistuese për përmirësim të mëtejshëm si në vijim:

Adresimi i plotë dhe cilësor i rekomandimeve tona si dhe çështjet e ngritura të pajtueshmërisë mbesin ende sfidë për Komunën e Rahovecit. Një progres në menaxhimin e organizatës, kryesisht në arkëtimin e të hyrave, në shlyerjen e borxheve të prapambetura, si dhe veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale me donatorë të ndryshëm. Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njësive dhe kryetarit, por mungon procesverbalet e takimeve si dhe monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlidh objektivat e komunës me rezultatet.

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

Mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më hollësisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komuna posedonte planin e integruar (2016-2018), planin e modalitetit urban (2016-2020), planin e menaxhimit të mbeturinave (2017-2021), planin zhvillimor komunal (2011-2020) dhe planin gjeneral urbanistik. Megjithatë, ende mungonin planet tjera strategjike si: planet hapësinore, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Auditimi i Brendshëm nuk kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, ndërsa komiteti i auditimit gjatë këtij viti ka qenë me veprime me funksionale.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. NjAB kishte përfunduar 10 auditimet e planifikuara, si dhe kishte kryer një auditim shtesë me kërkesë të menaxhmentit.

Çështja C5 - Funksionimi jo efikas i NjAB

Gjetja NjAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm. Sipas Planit të veprimit të përgatitur nga kjo njësi nga 53 rekomandime, 21 - ishin në proces të zbatimit, ndërsa pjesa tjetër prej 32-ishin zbatuar. Ne listën kontrolluese e adresimit të rekomandimeve për vitin 2018 sipas auditimeve të përfunduara nga kjo njësi, nuk janë vendosur faktet (dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse) që tregojnë se ka veprime konkrete për rekomandimet e zbatuar, nga të gjeturat e auditimit. Komiteti i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur tri takime me NjAB, por edhe më tej ndikimi i komitetit nuk është vërejtur përmirësim të aktiviteteve të menaxhmentit të komunës në adresimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos dokumentimi i fakteve se ka veprime konkrete se rekomandimi është zbatuar nga drejtorit e audituara me dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme do të dëmtojë efektivitetin e punës së NjAB dhe do të zvogëlojë mundësinë që ZKA të marrë siguri nga puna e NjAB, përkundër volumit dhe cilësisë së punës së ndërmarrë. Po ashtu dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuara, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm, humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para.

Rekomandimi C5 Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari i Komunës duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarrë nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të bashkëpunojë me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. Si dhe të sigurojë se një rishikim i kontrollit të cilësisë do të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë edhe më teje jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B2 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

- Gjetja** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Ne kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve në veçanti niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit nga kategoria e investimeve dhe mallrave, shërbimeve. Komuna gjithashtu edhe gjatë vitit 2018 nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive.
- Rreziku** Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimin e planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raporteve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komuna e Rahovecit ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Më tutje, komuna nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tyre. Kjo ka ndikuar që vetëm një pjesë e rekomandimeve të zbatohen dhe të përsëriten mangësitë e njëjta në disa fusha. Ansamble ja Komunale e Rahovecit me 26 Korrik 2018 ka shqyrtuar dhe është diskutuar në lidhje me raportin e auditimit të ZKA-së për vitin 2017. Përkundër angazhimeve të potencuar, pjesa më e madhe e rekomandimeve kanë mbetur në proces të zbatimit, ose të pazbatuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, katër (4) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë mbyllur; pesë (5) ishin në proces dhe dy (2) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale, regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale, detyrimeve kontingjente, si dhe të siguroj se komuna ka plotësuar pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar me status të nëpunësit civil. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Janë marrë veprime konkrete komuna ka plotësuar pozitën e ZKF, ka arritur të bëjë regjistrimin e pasurive kapitale por jo edhe të stokeve, si edhe me tej kemi keq klasifikim të shpenzimeve.	Pjesërisht është zbatuar.
2	Të hyrat	Kryetari duhet ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që bëhet verifikimi i 1/3-tës të pronave, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë. Veprime shtesë duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet vetëm për vendbanimet kryesore.	Gjatë testimeve dhe analizës së data bazës, si dhe ndryshimit të ligjit në Tatimin në pronë, janë ndërmarr veprimet e nevojshme.	Është zbatuar.
3	Vonesa në arkëtimin e qirasë	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave konform kushteve të kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për arkëtimin e mjeteve nga qiraja.	Përveç vërejtjeve, komuna nuk ka aplikon masa tjera ligjore, mirëpo këtë vit është riformuluari.	Nuk është zbatuar.

4	Menaxhi m jo adekuat i dosjeve/t ë dhënavave të personelit	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim të menaxhimit të stafit, si dhe matjes së performancës së tyre (vlerësimin vjetor të punës). Për vlerësimin e performancës, komuna duhet të nxjerrë akt (politikë) të brendshëm..	Gjatë auditimit kemi vërejtur se dosjet e personelit ende nuk janë të kompletuar.	Pjesërisht është zbatuar.
5	Kontrata pa procedurë të prokurimit	Kryetari i Komunës të sigurohet që është duke u aplikuar Ligji i Prokurimit Publik, me qëllim që çdo shërbim të kontraktohet duke u bazuar në konkurrencë.	Gjatë auditimit, nuk kemi vërejtur se komuna aplikon marrëveshje për shërbime pa procedurë të prokurimit. .	Është zbatuar.
6	Subvencione dhe transfere	Kryetari të siguroj se pagesat bëhen në llogari zyrtare të përfituesit të subvencionit si dhe të sigurojë se janë marrë masa adekuate për tu siguruar se regjistri i gjendjes civile është duke u azhurnuar në baza të rregullta.	Këtë vit komuna ka ndërmarr masa që pagesat të bëhen në llogarinë zyrtare të përfituesit.	Është zbatuar.
7	Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore	Kryetari duhet të siguroj kontrolle të shtura të kontraktimit, në mënyrë që para se të hyhet në obligime kontraktuale, fondet buxhetore të jenë të zotuar. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunës.	Komuna edhe këtë vit vazhdon të këtë të njëjtën gjendje. Kjo ndërlidhet me rekomandimin C3.	Rekomandim i mbyllur
8	Vonesa në ekzekutimin e pagesave	Kryetari të sigurohet se është vendosur disiplinë e duhur financiare që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit dhe mbajtjes në kontroll të obligimeve kontraktuale.	Nuk janë ndërmarr masa edhe gjatë këtij viti që faturat të paguhen brenda afatit ligjor	Pjesërisht është zbatuar.
9	Menaxhimi i dobët i pasurive	Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve.	Komuna ka ndërmarr disa aktivitetet për menaxhimin e pasurisë sipas Rregullores, mirëpo ende mungon evidenca /regjistrimi i stoqeve.	Pjesërisht është zbatuar.

10	Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve.	Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Duhet të siguroj se në librin e protokollit, do të regjistrohen dhe protokollohet të gjitha faturat e pranuar. Me tutje, të krijojë një sistem efektiv të kontrollit në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Janë marr veprime konkrete , komuna ka aplikuar raportime të rregullta mujore për obligimet në MF.	Është zbatuar.
11	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve.	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen brenda afateve të parapara, të rishikohen dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Me gjithë hartimin e një plani të veprimit, një monitorim i tij edhe me teje është jo efektiv pasi edhe këtë vit komuna ka treguar dobësi në menaxhimin financiar, kontrolleve dhe raportimit.	Rekomandim i mbyllur.
12	Mangësi në funksionimin e NjAB-it dhe KA-së	Kryetari të siguroj se fushëveprimi i NjAB-së, të mbulojë sa më shumë periudhën aktuale duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim. Njëkohësisht, të sigurohet një fokus më i lartë i menaxhmentit në funksionalizimin e KA-së drejtë përmbushjes së këtij qëllimi.	Raportet edhe me tej nuk mbulojnë periudhën aktuale, me gjithë funksionalizimin e Komitetet të Auditimit shumë nga rekomandime të kësaj njësi nuk janë zbatuar.	Pjesërisht është zbatuar
13	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Mos realizimi i buxhetit në nivel të kënaqshme nga disa kategori , mos hartimi i listës së rreziqeve, niveli i lartë të arkëtushmeve, janë fakte se nuk është përcaktuar dhe kryer një raportim i mirë.	Nuk është zbatuar.

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	PFV	<p>Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në klasifikimin e drejt të shpenzimeve dhe për të eliminuar dobësitë në prezantimin e drejt të llogarive të arkëtushmeve dhe obligimeve, të shpalosura në theksimin e çështjes te opinionit i auditimit.</p> <p>Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>
2	Niveli i Realizimi Buxhetit	<p>Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe i adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Planifikimi buxhetit duhet ti referohet mundësimeve reale për sigurimin e fondeve nga të hyrat dhe realizimit me prioriteti të buxhetit për fshirjen e obligimeve të prapambetura.</p>
3	Arkëtimi i të hyrave nga TP	<p>Kryetari duhet të vendos kontrole të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent.</p>
4	Arkëtimi nga Qeraja	<p>Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme departamentet përgjegjëse të arkëtoj të gjitha të hyrat e prapambetura. Në të kundërtën të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike apo ushtrimin e veprimtarisë, për mos kryerjen e obligimeve ndaj komunës.</p>
5.	Mungesa e dosjeve të Zjarrfikësve	<p>Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeveris dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendimi ti kthehen buxhetit të komunës.</p>
6	Mos azhurnimi dosjeve	<p>Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore/shëndetësorë dhe menaxheri i personelit duhet të kompletjnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë pushimet e stafit dhe vlerësimet e përformcës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.</p>

7	Parregullsi e angazhimit për shërbime të veçanta.	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta / kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plot me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike
8	Marrëveshje te bashkëfinancimit.	Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike.
9	Investimet Kapitale.	Kryetari duhet të sigurojë që personat përgjegjës kontrollojnë dokumentacionin e nevojshëm para ekzekutimit të pagesave si dhe të forcoj masat e kontrollit që punët apo mallrat pranoen nëpërmes dëshmive përkatëse apo raporteve të pranimit.
10	Investimet Kapitale	Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që realizimi i projekteve përmbushët brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe ekzekutimi i të gjitha pagesave të bëhet në pajtim me kontratën dhe të garantohen me sigurim të ekzekutimit duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme.
11	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat, duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejohet inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv si dhe duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve ku gabimet e tilla të mos përsëriten.
12	Investimet Kapitale	Kryetari të siguroj që zyra e prokurimit të ketë kontrolle të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve.
13	Investimet Kapitale	Kryetari, përmes Menaxherit të prokurimit duhet të sigurojë se çdo procedurë e prokurimit të analizohet dhe vlerësohet me kujdes nga ana e komisionit vlerësues, në mënyrë të evitohen gabimet e mundshme gjatë procesit të prokurimit gjithashtu të sigurohen që po respektohen kriteret e përcaktuara ligjore.
14	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet komfor kërkesave ligjore dhe zyra e prokurimit para inicimit të procedurave të prokurimit për ekzekutimin e punëve të posedoje projektet e kompletuara.
15	Pagesat sipas Nen 39.2 dhe vendimeve gjyqësore.	Kryetari i Komunës duhet të forcoj kontrollet për tu siguruar se disponojnë fonde të nevojshme për përmbushjen e obligimeve financiare me kohë. Më tej të siguroj se komuna trajton të gjitha obligimet ligjore ndaj pretendentëve legjitim dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim të eliminimit të shpenzimeve të panevojshme shtesë.

16	Mangësi në inventarizim in e pasurisë .	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.
17	Menaxhimi i Autoparkut.	Kryetari duhet të siguroj se do të hartohet një politik e brendshme e cila definon qartë kërkesat dhe përgjegjësitë për përdorimin e veturave. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se gjatë përdorimit të automjeteve zyrtare azhurnohen fletudhëtimet dhe veturat përdoren vetëm sipas aprovimeve të personave përkatës.
18	Të arkëtueshm et.	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.
19	Obligimet e pa paguar	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.
20	NJAB	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari i Komunës duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të bashkëpunoj me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. Si dhe të sigurojë se një rishikim i kontrollit të cilësisë do të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB.
21	Raportimi financiar dhe operativ.	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, përtëcilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmim



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. 

Kryetar i Komunës,

Data: 05.Prill.2019, Rahovec,